

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetari I trupit gjykues-gjyqtari Sahit Krasniqi, dhe anëtarët e trupit gjykues - gjyqëtares Imri Sejda dhe Bahri Salihu, me Sekretaren Juridike Adelina Sallahu, në çështjen penale kundër të akuzuarit R.A. nga fsh. Komuna Ferizaj, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së, sipas aktakuzës së ish Prokurorisë Publike të Qarkut në Prishtinë PP.nr.506/01 të datës 26.09.2001, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të dt. 22.11.2016, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës prokurorit të shtetit Rasim Malokut, të akuzuarit R.A. dhe mbrojtësit të tij av. E. H. –V. (e caktuar sipas detyrës zyrtare), të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R.A.**, data e lindjes.... në fsh. Komuna Ferizaj, me vendbanim të njejtë, nga I ati M. dhe e ëma F. e vajzërisë N., I martuar, babe I 4 fëmijëve, ka të kryer shkollen e mesme, I gjendjës së varfer ekonomike, me numer personal, ka qenë në paraburgim prej dt. 04.10.2005 deri me dt.12.04.2006

ESHTE FAJTOR

Sepse : me dt. 04.10.2005 pas mesnatës në kafiterin “....., prone e të dëmturit E.Xh., e cila ndodhet në rr. “.....” në Ferizaj, pa autorizim ka përdorur armën me qëllim friksimi, në atë mënyrë që pas një mosëmarrvëshje me të dëmtuarin deri sa kanë qenë duke luajtur lojën e bixhozit me zara, në të cilën loj I pandehuri kishte humbur para në vlerë prej 1000 euro, I dëmtuari ishte tërhequr nga loja, kështu që I pandehuri I revoltuar nga sjellja e të dëmtuarit ka shkuar në shtëpinë e tij në fsh. ku e ka marrë pushken automatike AK 47 dhe dy karikator të mbushur me municion, është kthyer prapë në lokalit ku ishte duke luajtur dhe kur afrohet te

hyrja ka shtënë disa here me pushkë automatike, pastaj hynë edhe brenda në kafiteri ku gjithashtu ka shtënë edhe disa here dhe pastaj largohet nga lokali, pa shkaktuar pasoja në njerëz përveq dëmeve material.

- **Me çka ka kryer vepren penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytësim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së.**

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të theksuara ligjore dhe të nen. 3, 5, 6, 11, 15, 34, 38, 64, 66 par.1 nënpar.4 të KPPK-se si dhe nen.391 të KPPK-së, të akuzuarin e:

G J Y K O N

Me DENIM BURGIMI në kohëzgjatje prej **6/gjashtë/muaj**, në të cilin denim llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga **dt. 04.10.2005 deri me dt.12.04.2006.**

Konform nenit 328 par.5 të KPK-sësë, konfiskohet në mënyrë të përhershme pushka automatike AK47 dhe dy karikatorët.

I dëmtuari E.Xh. nuk ka parashtruar kërkesë pasuroro juridike.

Obligohet I pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajn shumen prej 50 (pesëdhjetë) € në afat prej 15 ditëve nga dita e plotëfauqishmerisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

II.

Conform nenit 389 par.1 nënpar 1 të KPPK-së ndaj të akuzuarit R.A. u refuzua aktakuza për vepren penale shkaktim I rrezikut të përgjithshëm nga neni 291 par.3 lidhur me par.1 të KPK-së , pasi që prokurori I shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt. 22.11.2016 është tërhequr nga aktakuza për këtë vepëxzr penale për shkak **të parashkrimit absolut** të ndjekjës penale, dhe për vepren penale mbjatja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të

pa autorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPK-së, për shkak se vepra penale është përfshirë në amnisti sipas ligjit nr.04/L-209 të dt.19.09.2013.

Shpenzimet e procedurës penale për pjesën refuzuese të aktgjykimit bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Kryetari I trupit gjykues ne kuptim të nenit 394 par.1 te KPPK-së me dt. 22.11.2016 shpalli aktgjykimin, I udhezoi palët për të drejten e ankesës dhe për detyrimin për të paralajmëruar ankesen. Pas kësaj prokurori I shtetit, I akuzuari, dhe mbrojtësi I të akuzuarit deklaruan se heqin dorë nga e drejta e ankeses kundër aktgjykimit pra nuk paralajmrojn ankesë.

Andaj në kuptim të nenit 400 par.3 të KPK-së aktgjykimi I përpiluar me shkrim nuk është I nevojshëm të përmbaj arsyetimin.

Nga arsyet e sipërcekura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA,
PKR.nr.132/16 e dt. 22.11.2016**

Sekretaja Juridike
Adelina Sallahu

Kryetari i trupit gjykues,
Sahit Krasniqi